



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 14

Tiranë – E premte, 7 shkurt 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 5.2.2020	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për heqjen reciproke të vizave për qëndrim afatshkurtër, për mbajtësit e pasaportave diplomatike të shërbimit dhe private për shtetasit e të dyja vendeve.....	1075
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 90, datë 5.2.2020	Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike, për vitin 2020.....	1077
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 91, datë 5.2.2020	Për miratimin e buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2020.....	1079
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 94, datë 5.2.2020	Për miratimin e dokumentit të ndryshimit nr. 1 të kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin e ndërtimit të <i>bypass</i> -it të Fierit.....	1079
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 95, datë 5.2.2020	Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve organikë dhe të fondeve buxhetore në njësitë e qeverisjes qendrore, për vitin 2020.....	1083
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 96, datë 5.2.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 276, datë 16.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar”.....	1084
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 97, datë 5.2.2020	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës ‘Isuf Balta’, Tiranë”.....	1084
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 98 , datë 5.2.2020	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban dhe sistemimi i sheshit në fshatin Donofrosë, Njësia Administrative Cukalat”, Bashkia Ura Vajgurore.....	1088

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 5.2.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 777, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”.....	1090
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 100, datë 5.2.2020	Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2020.....	1090
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 5.2.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 308, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor”, të ndryshuar.....	1091
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 5.2.2020	Për caktimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si njësi zbatuese për ngritjen e portalit unik qeveritar të procesit të rindërtimit dhe financimin e tij nga fondi i rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020.....	1095
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 4, datë 29.1.2020	Për delegimin e të drejtave dhe të detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.....	1095
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Gentian Muhamet Beqiri.....	1112



VENDIM
Nr. 89, datë 5.2.2020

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT
TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË MBRETËRISË SË
ARABISË SAUDITE, PËR HEQJEN
RECIPROKE TË VIZAVE PËR
QËNDRIM AFATSHKURTËR, PËR
MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE TË SHËRBIMIT DHE
PRIVATE PËR SHTETASIT E TË DYJA
VENDEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për heqjen reciproke të vizave për qëndrim afatshkurtër, për mbajtësit e pasaportave diplomatike të shërbimit dhe private për shtetasit e të dyja vendeve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË MBRETËRISË SË ARABISË
SAUDITE, MBI HEQJEN RECIPROKE TË
VIZAVE PËR QËNDRIM AFATSHKURTËR
PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE TË SHËRBIMIT DHE
PRIVATE PËR SHTETASIT E TË DYJA
VENDEVE

Bazuar në marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet Këshillit të Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite (këtej e tutje referuara si “Palët”), përpjekjet e tyre për t’i forcuar këto marrëdhënie bilaterale ndërmjet dy vendeve, me dëshirën reciproke për të lehtësuar procesin e lëvizjes së shtetasve të tyre, në përputhje me parimin e reciprocitetit,

Palët kanë ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetasit e të dyja Palëve mund të hyjnë pa vizë (për misione zyrtare dhe private) në territorin e palës tjetër pa viza për qëndrim të pandërprerë ose me disa qëndrime, për një periudhë që nuk duhet të kalojë (90) ditë brenda (180) ditëve, duke paraqitur një pasaportë të vlefshme diplomatike ose private (vetëm për shtetasit sauditë) dhe një pasaportë të vlefshme diplomatike ose shërbimi (vetëm për shtetasit shqiptarë).

Neni 2

Shtetasit e të dyja Palëve, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe private (vetëm për shtetasit sauditë) dhe mbajtës të pasaportave diplomatike ose shërbimi (vetëm për shtetasit shqiptarë) duhet të aplikojnë për vizë për qëndrim të pandërprerë ose me disa qëndrime për qëndrime më të gjata se ai i parashikuar në nenin 1.

Neni 3

Shtetasit e secilës palë që hyjnë në territorin e vendit tjetër, në përputhje me parashikimet e nenit 1, duhet të respektojnë ligjet kombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Palët bëjnë pjesë, si dhe rregullat dhe zakonet e Palëve gjatë gjithë qëndrimit të tyre.



Neni 4

Parashikimet e nenit 1 të këtij memorandumi nuk zbatohen për shtetasit shqiptarë, të cilët hyjnë në territorin e Mbretërisë së Arabisë Saudite për kryerjen e riteve fetare të Haxhit dhe të Umras, ata duhet të pajisen me vizë, e cila jepet vetëm për këtë arsye.

Neni 5

Palët do të koordinojnë me njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, lidhur me vizitat zyrtare para mbërritjes në secilin prej vendeve.

Neni 6

Në përputhje me parashikimet e nenit 1 të këtij memorandumi, shtetasit e secilës palë që hyjnë në territorin e vendit tjetër, nuk lejohen të angazhohen në ndonjë aktivitet pune, gjatë gjithë qëndrimit të tyre, përveç rasteve kur ajo është në përputhje me rregullat dhe ligjet e secilës palë.

Neni 7

Të dyja Palët do të shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike, modelet e reja dhe të ndryshuara të pasaportave diplomatike në përdorim (vetëm për shtetasit sauditë) dhe pasaportave diplomatike dhe të shërbimit në përdorim (vetëm për shtetasit shqiptarë). Secila nga Palët do të informojë Palën tjetër për kushtet e lëshimit dhe të përdorimit të këtyre pasaportave. Secila nga palët do të informojë palën tjetër për çdo ndryshim lidhur me modelin e këtyre pasaportave dhe me termat e lëshimit apo të përdorimit sa më parë të jetë e mundur, të paktën 60 ditë përpara datës së ndryshimit dhe do të informojë çdo rast vjedhjeje dhe humbjeje apo nxjerrjeje jashtë përdorimit të këtyre pasaportave brenda 60 ditëve nga rasti.

Neni 8

Palët do të sigurojnë që informacioni dhe dokumentacioni i shkëmbyer ndërmjet tyre, do të përdoret ekskluzivisht për qëllimet që u janë caktuar atyre, në përputhje me atë që kanë rënë dakord. Ky informacion dhe dokumentacion nuk duhet t'i kalojë një palë të tretë pa miratimin e Palëve të paraqitur me shkrim.

Neni 9

Secila palë ka të drejtë të pezullojë zbatimin e këtij Memorandumi, në tërësi ose pjesërisht, për qëllime të cilat kanë lidhje me sigurinë kombëtare ose rendin publik, ose shëndetin publik. Ky pezullim do të hyjë në fuqi, pasi të njoftohet pala tjetër me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Ky Memorandum mund të riaktivizohet më pas nga Palët, me marrëveshje ndërmjet tyre.

Neni 10

1. Ky Memorandum mund të ndryshohet me marrëveshje ndërmjet Palëve, në përputhje me procedurat e tyre përkatëse ligjore.

2. Palët do të zgjidhin çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre për interpretimin ose për zbatimin e këtij Memorandumi, me konsultime nëpërmjet kanaleve diplomatike dhe në mënyrë miqësore me qëllim që t'i shërbejë interesit të tyre të përbashkët.

3. Ky Memorandum hyn në fuqi nga data e njoftimit të fundit ndërmjet Palëve, nëpërmjet kanaleve zyrtare, ky njoftim konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme ligjore për hyrjen e tij në fuqi.

4. Kohëzgjatja e këtij Memorandumi është pesë vjet dhe mund të rinovohet automatikisht për periudha të tjera të ngjashme në vazhdim, përveçse kur njëra nga Palët njofton palën tjetër me shkrim, për dëshirën e saj për ta përfunduar ose për të mos e rinovuar Memorandumin, së paku gjashtë muaj para nga data e përfundimit të tij.

Ky Memorandum u nënshkrua në qytetin e Riadit, datë 11.12.2019, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, arabe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë autentike. Në rast të divergjencave ndërmjet versioneve të sipërpërmendura, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gent Cakaj

**Ministër në detyrë për Evropën dhe Punët
e Jashtme**

PËR QEVERINË E MBRETËRISË SË
ARABISË SAUDITE

Faisal Bin Farhan Al Saud

Ministër për Punët e Jashtme

**VENDIM****Nr. 90, datë 5.2.2020****PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË
MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE
PUBLIKE, PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike, për vitin 2020, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësia përgjegjëse për planifikimin strategjik dhe zhvillimin, në Kryeministri, dhe të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2020.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



Lidhja nr.1

KALENDARI PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE, PËR VITIN 2020

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PËRKATËS
Janar	6	MoFE	Përgatit dhe paraqet në KM kalendarin e MSHP
Janar	8	KM	Shqyrton dhe miraton kalendarin e MSHP
Janar	13	MoFE	Paraqet në KM kuadrin makroekonomik e fiskal 2021-2023
Janar	20	KM	Miraton kuadrin makroekonomik e fiskal 2021-2023
Shkurt	13- 22	KM	Përgatit dhe miraton projekt-dokumentin e prioriteteve të politikave 2021-2023 me ndikim në tavanet buxhetore.
Shkurt	14	MoFE	Paraqet në KM tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2021-2023, për fazën strategjike
Shkurt	25	KM	Shqyrton dhe miraton tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2021-2023, për fazën strategjike
Shkurt	28	MoFE	Dërgon udhëzimin e përgatitjes së buxhetit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Mars	9	KM	Paraqet për informacion në Kuvend kuadrin makroekonomik e fiskal 2021-2023
Mars - prill	1 Mars -24 Prill	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
Prill	27 Prill-28 Prill	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile për PBA 2021-2023
Maj	1	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Paraqesin në MoFE kërkesat e tyre buxhetore
Maj	4 - 19 Maj	MoFE	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
Maj	4 - 19 Maj	KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e prioriteteve të politikave 2021-2023.
Maj	20 - 27 Maj	MoFE	Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Maj	28-29 Maj	MoFE	Prezanton dokumentin e PBA 2021-2023 me shoqërinë civile
Qershor	1	MoFE	Paraqet në KM kuadrin makroekonomik e fiskal të rishikuar <i>(në rast se shihet e nevojshme)</i>
Qershor	5	KM	Miraton kuadrin makroekonomik e fiskal të rishikuar <i>(në rast se shihet e nevojshme)</i>
Qershor	8	KM	Përgatit dhe miraton dokumentin e rishikuar të prioriteteve të politikave 2021-2023 me ndikim në tavanet buxhetore.
Qershor	9 -16 Qershor	MoFE	Përgatit dokumentin e PBA 2021-2023 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2021-2023.
Qershor	22	MoFE	Paraqet dokumentin e PBA 2021-2023 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2021-2023, për shqyrtim dhe miratim në KM.
Qershor	30	KM	Miraton dokumentin e PBA 2021-2023 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2021-2023
Korrik	7	MoFE	I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e PBA 2021-2023
Korrik	8	MoFE	Dërgon udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit në fazën teknike, në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Korrik - Gusht	10 Korrik - 31 Gusht	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare.
Shtator	1	Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme	Paraqesin në MoFE kërkesat e rishikuara buxhetore
Shtator	2-14 Shtator	MoFE	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator	2-14 Shtator	KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e rishikuar të prioriteteve të politikave 2021-2023
Shtator	15-25 Shtator	MoFE	Organizon seancat dëgjimore me njësitë e qeverisjes së përgjithshme
Tetor	5-12 Shtator	MoFE	Përgatit projektbuxhetin e vitit 2021, si dhe, dokumentin e rishikuar të PBA 2021-2023 dhe i paraqet për shqyrtim në KM
Tetor	15	KM	Miraton projektbuxhetin e vitit 2021, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2021-2023
Tetor	18	MF	Dërgon për informacion në Kuvend një kopje të dokumentit të rishikuar të PBA 2021-2023, të miratuar nga KM
Tetor	18	KM	I paraqet Kuvendit projektbuxhetin e vitit 2021



VENDIM
Nr. 91, datë 5.2.2020

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
PRONËSISË INDUSTRIALE, PËR
VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 189/c, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e buxhetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2020, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Tabela nr. 1

PLANI TË ARDHURA-SHPENZIME, PËR VITIN 2020

000/lek

Të ardhurat		Shpenzimet	
Të ardhura nga aktiviteti kryesor	125,000	Shpenzime personeli	45,000
Të trashëguara investime dhe projekte në vazhdim	89,335	Shpenzime operative dhe korrente	28,970
Marrëveshja e Madridit	67,000	Transferta korrente e jashtme	36,442
Marrëveshja e Hagës	1,075	Shpenzime kapitale	5,760
Të ardhura nga marrëveshja e shtrirjes me ZEP-në	500	Totali i shpenzimeve	116,172
		Teprica derdhjeje në buxhetin e shtetit	166,738
Totali i të ardhurave	282,910	Totali i shpenzimeve dhe teprica në buxhetin e shtetit	282,910

VENDIM
Nr. 94, datë 5.2.2020

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT
TË NDRYSHIMIT NR. 1 TË
KONTRATËS FINANCIARE NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS EVROPIANE TË
INVESTIMEVE, PËR PROJEKTIN E
NDËRTIMIT TË
BYPASS-it TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e dokumentit të ndryshimit nr. 1 të kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin e ndërtimit të *bypass*-it të Fierit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



FI N⁰ 31.045 (AL)
Serapis N⁰ 2007-0204

BYPASS-i I FIERIT

MARRËVESHJE AMENDIMI NR. 1
NË LIDHJE ME KONTRATËN
FINANCIARE TË NËNSHKRUAR MË
11 QERSHOR 2012, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE
Luksemburg, 19 dhjetor 2019
Tiranë, 31 dhjetor 2019

KJO MARRËVESHJE LIDHET NDËR-
MJET:

1. Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”); dhe
2. Bankës Evropiane të Investimeve (“Banka”);
Së bashku të referuara si “Palët”.

INFORMACION PARAPRAK

A. Palët kanë lidhur kontratën e financimit në datën 11 qershor 2012 (“Kontrata financiare”).

B. Në vijim të kërkesës së marrë më 26 dhjetor 2018 nga Huamarrësi, Palët kanë rënë dakord të hyjnë në këtë marrëveshje amendimi (në vijim e referuar si “Marrëveshja e amendimit”), me qëllim amendimin e disa termave të kontratës financiare.

Është rënë dakord si më poshtë:

1. INTERPRETIMI

Përkufizimet

Termat me germa të mëdha të përcaktuar në kontratën financiare kanë të njëjtin kuptim kur përdoren në këtë marrëveshje amendimi, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe.

2. AMENDIMET

Kontrata financiare është ndryshuar siç përcaktohet më poshtë.

2.1 Përkufizimi “Data përfundimtare e vlefshmërisë” e kontratës financiare do të ndryshojë për t’u lexuar si më poshtë:

“**Data përfundimtare e vlefshmërisë**” është data 31 janar 2021.”.

2.2 Përkufizimi “Normë e ndryshueshme” e kontratës financiare do të ndryshojë për t’u lexuar si më poshtë:

“**Normë e ndryshueshme**” është një normë interesi e ndryshueshme me shpërndarje fikse, që do të thotë një normë vjetore interesi e përcaktuar nga Banka për çdo periudhë reference pasuese të normës së ndryshueshme me normën përkatëse ndërbankare, plus ose minus shpërndarjen (*Spread*).

Në rast se norma e ndryshueshme për çdo periudhë reference të normës së ndryshueshme llogaritet të jetë nën zero, do të caktohet zero.”.

2.3 Neni 1.04B(a)(vi), do të ndryshojë për t’u lexuar si më poshtë: “përveç transhit të parë, dëshmi që mund të pritët në mënyrë të arsyeshme se Huamarrësi dhe/ose Zbatuesi do të kenë shkaktuar, deri në ditën e 180-të që bie pas datës së preferuar për disbursimin e specifikuar në kërkesën për disbursim, shpenzimet kualifikuese në një sasi të paktën të barabartë me agregatin/totalin e përgjithshëm:

i. 100% (njëqind për qind) e shumave të të gjitha transheve të disbursuara më parë; dhe

ii. 80% (tetëdhjetë për qind) të shumës së transhit për t’u disbursuar (100% (një qind për qind) e shumës së transhit, nëse ky transh është transhi i fundit për t’u disbursuar);”.

2.4 Neni 1.06A, “E drejta e Huamarrësit për anulim”, do të ndryshojë për t’u lexuar si më poshtë: “Huamarrësi, me njoftim me shkrim drejtuar Bankës, mund të anulojë në çdo kohë, tërësisht apo pjesërisht dhe me efekt të menjëhershëm, pjesën e padisbursuar të kredisë. Megjithatë, njoftimi nuk do të ketë efekt, në lidhje me: a) një transh të njoftuar që ka një datë disbursimi të planifikuar që bie brenda 7 (shtatë) ditësh pune nga data e njoftimit; ose b) një transh për të cilin është dërguar një kërkesë disbursimi, por nuk është lëshuar një njoftim disbursimi.”.

2.5 Nenet aktuale 12.01 dhe 12.02 do të zëvendësohen nga nenet e reja 12.01 dhe 12.02:

“12.01 Format e njoftimit

a) Njoftimet dhe komunikimet e tjera të dhëna sipas kësaj kontrate duhet të bëhen me shkrim dhe, përveç rasteve kur deklarohet ndryshe, duhet të bëhen nga një nënshkrues i autorizuar me anë të shkresës, postës elektronike dhe faksit.

b) Njoftimet dhe format e tjera të komunikimit për të cilat periudha fikse përcaktohen në këtë kontratë apo që caktojnë periudha detyruese për marrësin, duhet të bëhen me dërgim dorazi, me postë rekomande (të regjistruar), faks ose postë elektronike. Këto njoftime dhe komunikime do të çmohen të marra nga pala tjetër:

i. në datën e dorëzimit në lidhje me shkresën e dërguar dorazi ose me postë rekomande;

ii. ose me konfirmimin e marrjes në lidhje me transmetimin me faks;



iii. në rast të çdo poste elektronike të dërguar nga Huamarrësi te Banka, vetëm kur të merret njoftimi se është lexuar;

iv. në rast të çdo poste elektronike të dërguar nga Banka te Huamarrësi, në momentin kur dërgohet posta elektronike.

c) Çdo njoftim i dërguar nga Huamarrësi për Bankën me anë të postës elektronike duhet të:

i. përmendë numrin e kontratës te hapësira e caktuar të lëndës; dhe

ii. jetë në formën e një imazhi elektronik të paredaktueshëm (PDF, TIF ose ndonjë formal tjetër të zakonshëm të paredaktueshëm për të cilin është rënë dakord ndërmjet palëve) të njoftimit të nënshkruar nga një nënshkrues i autorizuar, me të drejtën e përbashkët të përfaqësimit të Huamarrësit sipas rastit, bashkëlidhur postës elektronike.

d) Pa ndikuar në vlefshmërinë e njoftimeve apo komunikimeve me postë elektronike apo faks, të bërë në përputhje me këtë nen 12.01, njoftimet, komunikimet dhe dokumentet e mëposhtme do t'i dërgohen palës përkatëse edhe me postë rekomande, të paktën menjëherë në ditën vijuese të punës:

i. kërkesa për disbursim;

ii. revokimi i kërkesës për disbursim sipas nenit 1.02C;

iii. çdo njoftim dhe komunikim, në lidhje me shtyrjen, anulimin dhe pezullimin e disbursimit të çdo transhi, rishikimin e interesit ose konvertimit të çdo transhi, luhatjet e tregut, kërkesë parapagimi, njoftim parapagimi, rast të mospërmbushjes së kërkesave, çdo kërkesë për parapagim; dhe

iv. çdo njoftim, komunikim apo dokument të kërkuar nga Banka.

e) Palët bien dakord që çdo komunikim i mësipërm (duke përfshirë atë me postë elektronike) është një formë e pranuar e komunikimit dhe do të përbëjë prova të pranueshme në gjykatë dhe do të ketë të njëjtën vlerë provuese si një marrëveshje e nënshkruar.

f) Banka dhe Huamarrësi do të njoftojnë menjëherë palën tjetër, me shkrim, në lidhje me çdo ndryshim të të dhënave të tyre përkatëse të komunikimit.

12.02 Adresat për njoftimet

Adresa, numri i faksit dhe adresa e postës elektronike (dhe departamenti ose zyrtari, nëse ka, në vëmendjen e të cilit do të bëhet komunikimi) të secilës palë për çdo komunikim

që duhet të bëhet ose dokument që duhet të dorëzohet nën ose në lidhje me këtë kontratë, është:

PËR HUAMARRËSIN

*Në vëmendje të: ministrit të Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Republika e Shqipërisë*

Adresa e email-it: dept.department@financa.gov.al

debt.department@financa.gov.al

KOPJE PËR ZBATUESIN

Në vëmendje të:

Autoritetit Rrugor Shqiptar

Ekipi i Zbatimit të Projektit

Drejtori i EZP-së

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit e Republikës së Shqipërisë

Rr.: “Sami Frashëri”, nr. 33, Tiranë, Shqipëri

Faks: +355 4 2259 898

Adresa e email-it: <generic email>

PËR BANKËN

Në vëmendje të: OPSIMA/3-PUB SEC (SI,HR, WBs)

100 Boulevard Konrad Adenauer

L-2950 Luxembourg

Faks: +352 4379 67487

Email: EIB-MA-Implementation@eib.org.”

2.6 Skeduli aktual B do të zëvendësohet nga skeduli i ri B i përcaktuar në shtojcën I të kësaj marrëveshjeje amendimi.

2.7 Paragrafi i titulluar “Kalendari i përshkrimit teknik” i përcaktuar në skedulën A.1, do të ndryshohet për t’u lexuar si më poshtë: “Ndërtimi i projektit pritet të fillojë në tremujorin 1, 2012 dhe të përfundojë deri në tremujorin 1 të vitit 2020.”.

2.8 Tabela, sipas paragrafit 1, e titulluar “Dërgimi i informacionit: caktimi i personave përgjegjës”, i informacionit të projektit që duhet t’i dërgohet Bankës dhe metoda e transmetimit e përcaktuar në skedulën A.2, do të ndryshojnë për t’u lexuar si më poshtë:

Zbatuesi	Autoriteti Rrugor Shqiptar
Personi i kontaktit	Z. Ergys Verdho
Titulli	Drejtor i përgjithshëm
Adresa	Rr. “Sami Frashëri”, nr. 33, Tiranë, Shqipëri
Telefon	+355 22 34487
Email	ergys.verdho@arrsh.gov.al ; info@arrsh.gov.al



2.9 Përkufizimi “Data e dorëzimit në Bankë” e paragrafit 4, të titulluar “Informacion mbi përfundimin e punimeve dhe vitin e parë të veprimtarisë”, e informacionit të Projektit që i duhet dërguar Bankës dhe metodat e transmetimit të përcaktuara në skedulin A.2, do të ndryshojnë për t’u lexuar si më poshtë: “30 prill 2021”.

3. LIGJI RREGULLUES DHE JURIDIKSIONI

3.1 Ligji rregullues

Kjo marrëveshje amendimi dhe çdo detyrim jokontraktual, që rrjedh nga ose në lidhje me të, do të rregullohen nga ligjet e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

3.2 Juridiksioni

Palët e kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian.

4. DATA E HYRJES NË FUQI

Kjo marrëveshje amendimi do të hyjë në fuqi pas konfirmimit nga Banka për Huamarrësin se ajo ka marrë komunikimin me shkrim të Huamarrësit, në lidhje me plotësimin e procedurave të tij të brendshme (“Hyrja në fuqi”).

Kjo marrëveshje amendimi është nënshkruar në 3 (tri) kopje origjinale në gjuhën angleze, ku secila faqe është siglur në emër të Huamarrësit dhe në emër të Bankës.

Nënshkruar për dhe në emër të	Nënshkruar për dhe në emër të
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE
Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Shef sektori
Anila Denaj	Oficer Huaje
	Jacopo Lensi Orlandi
	Fabienne Delavie

SHTOJCA I E MARRËVESHJES SË AMENDIMIT

Skeduli B Përkufizimi i EURIBOR-it

A. EURIBOR

“EURIBOR” nënkupton:

a) në lidhje me një periudhë përkatëse prej jo më pak se një muaj, norma e interesit (siç përcaktohet më poshtë) për një periudhë prej një muaji;

b) në lidhje me një periudhë përkatëse të një apo më shumë muajsh të plotë, për të cilën është e disponueshme një normë interesi, norma e interesit për një periudhë të numrave korrespondues të muajve; dhe

c) në lidhje me një periudhë përkatëse prej më shumë se një muaji, për të cilin nuk është e disponueshme një normë interesi, norma që rezulton nga një interpolim linear me referencë ndaj dy normave për depozitat në euro, njëra prej të cilave është e zbatueshme për një periudhë të mëpashme të shkurtër dhe për një periudhë tjetër më të gjatë se sa gjatësia e periudhës përkatëse,

(periudha për të cilën norma është marrë ose nga të cilat normat janë interpeluar referohet si “Periudha përfaqësuese”).

Për qëllime të paragrafëve (b) dhe (c) më sipër:

i. “të disponueshme” nënkupton normat, për maturimet e dhëna, të cilat janë llogaritur dhe publikohen nga *Global Rate Set Systems Ltd (GRSS)* ose një ofrues i tillë i shërbimeve, të përzgjedhura nga Instituti Evropian i Tregjeve të Parave (EMMI), nën sponsorizimin e EMMI-së dhe EURIBOR ACI, ose çdo pasues i atij funksioni të EMMI-së dhe EURIBOR ACI, siç përcaktohet nga Banka; dhe

ii. “normë interesi” nënkupton normën e interesit për depozitat në euro, për periudhën përkatëse, siç është publikuar në orën 11:00, ora e Brukselit apo në një orë të mëvonshme, të pranueshme për Bankën në atë ditë (“data e rivendosur”), e cila bie 2 (dy) ditë përkatëse pune para ditës së parë të periudhës përkatëse, në faqen e *Reuters EURIBOR 01* ose në faqen e pasuesit të saj ose, në mungesë të së cilës, me çdo



mjet tjetër publikimi të zgjedhur për këtë qëllim nga Banka.

Nëse këto norma nuk janë të publikuara, Banka do të kërkojë zyrat kryesore të katër bankave të mëdha të Eurozonës të zgjedhura nga Banka, të kuotojnë normën e depozitimit të euros në një shumë të krahasueshme, rreth orës 11:00 të Brukselit, në datën e rivendosur në tregjet bankare kryesore të Eurozonës për një periudhë të barabartë me periudhën e përfaqësimit. Nëse sigurohen të paktën 2 (dy) kuotime, norma për datën e rivendosjes do të jetë mjeti aritmetik i kuotimeve.

Nëse më pak se 2 (dy) kuotime merren pas kërkesës, norma për atë datë rivendosjeje do të jetë mjeti aritmetik i normave të kuotuar nga bankat e mëdha në euro zonë, të përzgjedhura nga Banka rreth orës 11:00, ora e Brukselit, në datën që bie 2 (dy) ditë përkatëse pune pas datës së rivendosur, për huat në euro, në një sasi të krahasueshme me Bankat Evropiane kryesore për një periudhë të barabartë me periudhën e përfaqësimit.

Nëse nuk ka norma të disponueshme, siç përcaktohet më lart, EURIBOR do të jetë norma (e shprehur si përqindje në vit) e cila caktohet nga Banka si kosto gjithëpërfshirëse për Bankën për financimin e transhit përkatës, bazuar në normën e referencës së Bankës, të gjeneruar brenda vendit ose një metodë alternative të përcaktimit të normës së përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga Banka.

B. TË PËRGJITHSHME

Për qëllimet e përkufizimit të mësipërm:

a) të gjitha përqindjet që rezultojnë nga llogaritjet e përmendura në këtë skedul do të jenë të rrumbullakosura, nëse është e nevojshme, me një të njëmijtën e një pikë përqindjeje më të afërt, me gjysma të rrumbullakosura;

b) Banka do të informojë Huamarrësin pa vonesë për kuotimet e marra nga Banka;

c) nëse ndonjë nga dispozitat e mësipërme bëhet e papajtueshme me dispozitat e miratuara nën kujdesin e EMMI-së dhe EURIBOR ACI (ose ndonjë pasues të atij funksioni të EMMI-së dhe EURIBOR ACI, siç përcaktohet nga Banka), Banka, me anë të njoftimit të Huamarrësit, mund të ndryshojë dispozitën për ta sjellë atë në përputhje me dispozitat e tjera të tilla.

VENDIM

Nr. 95, datë 5.2.2020

PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ORGANIKË DHE TË FONDEVE BUXHETORE NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE, PËR VITIN 2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 17, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të sistemit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për vitin 2020, reduktohet me 220 (dyqind e njëzet) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të sistemit të ministrisë në 879 (tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë) punonjës.

2. Numri i punonjësve të sistemit të Ministrisë së Brendshme, për vitin 2020, shtohet me 220 (dyqind e njëzet) punonjës për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, duke e çuar numrin e përgjithshëm të sistemit të ministrisë në 14 484 (katërmëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e katër) punonjës.

3. Në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për vitin 2020, në programin buxhetor “Programi për mbrojtjen e mjedisit” reduktohet fondi prej 49 300 000 (dyzet e nëntë milionë e treqind mijë) lekësh, në zërin “shpenzime korrente”, dhe në programin buxhetor “Administrimi i pyjeve” reduktohet fondi prej 43 700 000 (dyzet e tre milionë e shtatëqind mijë) lekësh në zërin “shpenzime korrente”.

4. Në programin “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”, për Ministrinë e Brendshme, shtohet fondi prej 93 000 000 (nëntëdhjetë e tre milionë) lekësh në zërin “shpenzime korrente”, për vitin 2020, për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

5. Numri i përgjithshëm i punonjësve organikë buxhetorë nuk ndryshon.

6. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.



7. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare jo më vonë se 30 ditë nga data e hyrjes në fuqi.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 96, datë 5.2.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 276, DATË 16.5.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË ORGANIZIMIT, TË STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE STATUTIT TË AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009, “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, dhe të pikës 5, të nenit 21, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 276, datë 16.5.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 9, e kreut IV, ndryshohet si më poshtë vijon:

“9. Numri i punonjësve të Autoritetit Rrugor Shqiptar është, gjithsej, 166 veta.”.

2. Në skemën 2, që përmendet në pikën 5, të kreut IV, bëhen këto ndryshime:

a) pozicionet “Specialist (IT)” në Sektorin e Shërbimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, shfuqizohen;

b) numri i punonjësve të nënndarjes 5.3, “Sektori i Shërbimeve”, bëhet 14 dhe numri i punonjësve të ndarjes 5, “Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme”, bëhet 22;

c) numri i punonjësve të Zyrës Qendrore të Autoritetit Rrugor Shqiptar bëhet, gjithsej, 112.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 97, datë 5.2.2020

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I RRUGËS ‘ISUF BALTA’, TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës “Isuf Balta”, Tiranë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, për pasuritë e llojit “truall”, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë të përgjithshme prej 51 306 408 (pesëdhjetë e një milionë e treqind e gjashtë mijë e katërqind e tetë) lekësh.

4. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasurinë e llojit “truall”, me vlerë 51 306 408 (pesëdhjetë e një milionë e treqind e gjashtë mijë e katërqind e tetë) lekë, do të përballohet nga fondet e Bashkisë Tiranë.

6. Shpenzimet procedurale në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë do të përballohen nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ndërsa shpenzimet procedurale në vlerën 1 557 508 (një milion e



pesëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetë) lekë, për publikim në organet e shtypit, do të përballohen nga subjekti kërkues, Bashkia Tiranë.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues pranë Bashkisë Tiranë.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit, mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë edhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI

Ndërtimi i rrugës “Isuf Balta”, Tiranë

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Pjesët takuese të bashkëpro nësisë	Z. K.	Nr. pasurie	Sip. e përgj. Truall m ²	Sip. e prekur Truall m ²	Çmimi Truall lekë/m ²	Sip. totale e objektit m ²	Sip. e objektit e prekur m ²	Çmimi për objekt lekë/m ²	Vlera (truall i prekur) lekë	Vlera (objekt i prekur) lekë	Vlera (truall + objekt) lekë	Konfirmimi i ZVRPP-së Tiranë	Shënime
1	Maliq Riza Bici		8330	3/407	320	119	34068				4054092		4,054,092	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Ka dy ndërtime të paligjshme
2	Flamur Bahir Flamuraj Bashkim Xhemal Toska Halit Jonus Elezaj	1/3 1/3 1/3	8330	3/418	72	13	34068				442884		442,884	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Ka një ndërtim të paligjshëm
3	Ardian Bejko		8330	3/419	328	91	34068				3100188		3,100,188	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Ka dy ndërtime të paligjshme
4	Bujar Zyber Skënderi Hysni Zyber Skënderi Liri Skënder Sinani Mahmudie Zyber Shkalla Nezhmie Skënder Fortuzi Sulltane Skënder Kazani	1/6 1/6 1/6 1/6 1/6	8330	3/883	1826	723	34068				24631164		24,631,164	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Mbi këtë pasuri bie ndërtesa nr. 3/89-ND, vol.51, f. 178, përfituar me leje legalizimi
5	Rezar Bujar Sula Eduard Bujar Sula Vildon Skënderi Pëllumb Skënderi Zana Prifti Pranvera Beqaj Mimoza Skënderi Zeliha Musi Haxhi Demir Mereme Dervishi Fatmir Demiri Fitnete Novosela Nexhmije Dedja Nimete Bilbili Bukurije Shijaku Shefqet Bega Gëzim Duraku Qëndresa Duraku Nazmije Caslli Mereme Allushi		8330	3/891	3644	473	34068				16114164		16,114,164	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Në përshkrimin e veçantë citohet: Sipërfaqja prej 542 m ² është pjesë e rrugës Isuf Balta, nuk është lëshuar certifikatë e pronës. Sipas VKM-së së shpronësimit nr. 220, datë 23.3.2016. Janë shpronësuar prej 73.4 m ² në favor të Blerim Ramazan Ahmataj. Në seksionin “D” ka shënimet: Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa me nr. Pasure 3/913-nd, vol. 49, f. 78. Mbi këtë pasuri, bazuar në lejen e legalizimit është regjistruar ndërtesa me nr. Pasure 3/589-nd, vol. 52, f. 9, zk. 8330. Mbi këtë



	Fiqirete Bega Ervin Bega Shyqyri Skënderi Ismail Skënderi Lumturi Çoku Aishe Mumajesi Fatbardha Kazani Afërdita Skënderi Ardian Skënderi Sokol Skënderi Meriban Demiri Adriana Hasibia Mehmet Demiri														pasuri pozicionohet ndërtesa nr. 3/955-nd, vol. 52, fq.19.
6	Arjan Medi Malushi Florent Dashnor Malushi Lelant Dashnor Malushi Olti Dashnor Malushi Roland Dashnor Malushi	2/6 1/6 1/6 1/6 1/6	8330	3/780	400	34	34068				1158312		1,158,312	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.01.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.02.2019.	Në seksionin D ka shënimin “Mbi këtë pasuri ndodhet ndërtesa 3/955-nd, vol. 52, faqe. 19
7	Mevlud Metush Ndreu		8330	3/101	283.2	19	34068	45.9	0	0	647,292	0	647,292	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.01.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.02.2019.	
8	Nuri Xhika, Kujtim Plaku		8330	3/605	303	19	34068	130.9	0	0	647,292	0	647,292	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.01.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.02.2019.	
9	Bilbil Hodo Xhaferasi		8330	3/600	200	15	34068	86.1	0	0	511,020	0	511,020	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.01.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.02.2019.	
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT							1,506				51,306,408		51,306,408		



VENDIM
Nr. 98, datë 5.2.2020

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI URBAN
DHE SISTEMIMI I SHESHIT NË
FSHATIN DONOFROSË, NJËSIA
ADMINISTRATIVE CUKALAT”,
BASHKIA URA VAJGURE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban dhe sistemimi i sheshit në fshatin Donofrosë, njësia administrative Cukalat”, Bashkia Ura Vajgure.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Ura Vajgure.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “ndërtesë + truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 51 935 (pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 51 935 (pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e

tridhjetë e pesë) lekësh, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Ura Vajgure.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përballohen nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Ura Vajgure.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Ura Vajgure, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Bashkisë Ura Vajgure.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit, Bashkia Ura Vajgure, për pasurinë e shpronësuar.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Ura Vajgure dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



**LISTA EMËRORE E PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA PROJEKTI
“RIKUALIFIKIMI URBAN DHE SISTEMIM I FSHATIT DONOFROSË, NJËSIA ADMINISTRATIVE CUKALAT”, BASHKIA URA VAJGJURORE**

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurie	Lloji i objektit	Sipërfaqe truallit	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit	Vlera e truallit	Vlera e ndërtimit	Vlera e truallit dhe e ndërtësës totale	Shënime
					m ²	m ²	lekë/m ²	lekë	lekë	lekë	
1	Altin Flamur Metohu	1515	52/19	ndërtësë + truall	200	70	203	40,600	11,335	51,935	Llogaritjet janë kryer duke u mbështetur në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, udhëzimin nr. 4, datë 30.9.2015 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, VKM nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 401, datë 23.10.1989 “Për miratimin e normave të reja të amortizimit”, Çmimet e Entit Kombëtar të Banesave të miratuara me udhëzimin e KM-së nr. 3, datë 28.12.2016, aktualisht në fuqi.
VLERA TOTALE								40,600	11,335	51,935	



VENDIM

Nr. 99, datë 5.2.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 777, DATË 26.12.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KONTROLLIN
ANTIPLAGJIATURË TË
DISERTACIONEVE PËR FITIMIN E
GRADAVE SHKENCORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “e”, të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 777, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Institucionet e arsimit të lartë kryejnë kontrollin digjital antiplagjiaturë të disertacioneve të përdorura për marrjen e gradës shkencore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”;

b) pika 6 shfuqizohet;

c) pika 7 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“7. Institucionet e arsimit të lartë njoftojnë ministrinë përgjegjëse për arsimin, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e vendimit përfundimtar, për rezultatet e gjetjeve nga kontrolli antiplagjiaturë dhe masat e marra pas rivlerësimit përfundimtar për gradën shkencore të dyshuar si plagjiaturë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM

Nr. 100, datë 5.2.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË
MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË
FINANCIMIT NGA FONDI I
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË E
ZHVILLIMIT RURAL, PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2020 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëri “Transferte në buxhetet familjare” (llogaria ekonomike 606), do të përdoret për:

a) rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve blegtorale, të prodhimeve bujqësore në mjedise të mbrojtura dhe uljen e kostove të prodhimit, nëpërmjet pagesave të kafshëve të matrikulluara e subvencionimit të çmimit të plastmasës;

b) shtimin e sipërfaqeve të mbjella me bimë mjekësore dhe aromatike;

c) certifikimin e produkteve bujqësore dhe fermave organike;

ç) mbështetjen e diversifikimit të aktiviteteve ekonomike në zonat rurale.

2. Masat e mbështetjes dhe masa e financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë, si më poshtë vijon:

a) Për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermat me jo më pak se 70 (shtatëdhjetë) krerë dele dhe/ose dhi, në vlerën 1 200 (njëmijë e dyqind) lekë/krerë, por jo më shumë se 360 000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë për subjekt, ndërsa për fermat me jo më pak se 5 (pesë) krerë lopë, në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë/krerë, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt;

b) Mbarështim i bletarisë me 1 000 (një mijë) lekë për zgjua, për ferma me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje, por jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për subjekt;



c) Zëvendësimi i plastmasës termike për serrat diellore ekzistuese për prodhimin e perimeve, rrushit për tavolinë dhe tunelet plastike për prodhimin e luleshtrydhes në vlerën respektive 300 000 (treqind mijë) lekë/ha dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë/ha, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt.

Sipërfaqja e serrës apo e tunelit plastik të jetë jo më pak se 0.2 (zero pikë dy) ha. Përfitues janë subjektet, të cilat nuk mund të mbështeten nga programi IPARD II.

ç) Mbjellje bimësh mjekësore e aromatike në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë për fermerët individualë dhe për grup fermerësh, ndërsa për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (në vijim “SHBB”), jo më shumë se 4 000 000 (katër milionë) lekë.

Sipërfaqja e mbjellë për fermerët individualë duhet të jetë jo më pak se 0.2 (zero pikë dy) ha, për grup fermerësh, jo më pak se 1 ha në një bllok të vetëm, për SHBB-të, jo më pak se 5 (pesë) ha. Madhësia e ngastrës të jetë jo më pak se 0.2 (zero pikë dy) ha, kur nuk është në bllok.

d) Fermat organike, për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë, 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë për fermë të certifikuar.

dh) Implementimi dhe certifikimi Global GAP në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore, por jo më shumë 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, në perime, fruta, rrush, ullinj dhe agrume, në sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha.

e) Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 (gjashtë) deri në 10 (dhjetë) dhoma, në 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet, të cilat nuk mund të mbështeten nga programi IPARD II.

3. Përfitues për masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural do të jenë fermerët, personat fizikë, personat juridikë dhe SHBB-të.

4. Kriteret, procedurat dhe mënyra e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural përcaktohen me

udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

5. Nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2020, do të përdoret shuma:

a) deri në 10 174 000 (dhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë) lekë, për pagesën e vlerës së palikuiduar, për subjektet e shpallura fituese nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, në zbatim të vendimit nr.128, datë 13.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2019”, të ndryshuar;

b) deri në 1 755 000 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë detyrime, për pagesat e normës së interesave bankare për kontratat e lidhura.

6. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 102, datë 5.2.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 308, DATË 21.5.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PAKETAVE TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË SHËRBIMIN SPITALOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Në vendimin nr. 308, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shtojcat referuar në shkronjat: “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “e”, bashkëlidhur vendimit, ndryshohen me shtojcat që i bashkëlidhen këtij vendimi, si më poshtë vijon:

a) Shtojca nr. 1, “Paketa e shërbimit të dializës”, zëvendësohet me shtojcën nr. 1, “Paketa e shërbimit të dializës, të vendosjes së fistulës së thjeshtë dhe vendosjes së graftit të thjeshtë”;

b) Shtojca nr. 2, “Paketa e shërbimeve të kardiologjisë”, zëvendësohet me shtojcën nr. 2, “Paketa e shërbimeve të kardiologjisë”;

c) Shtojca nr. 3, “Paketa e shërbimeve të kardiokirurgjisë”, zëvendësohet me shtojcën nr. 3, “Paketa e shërbimeve të kardiokirurgjisë”;

ç) Shtojca nr. 4, “Paketa e shërbimit të transplantit të veshkës dhe flakjes akute”, zëvendësohet me shtojcën nr. 4, “Paketa e shërbimit të transplantit të veshkës dhe flakjes akute”;

d) Shtojca nr. 5, “Paketa e shërbimit të implantit koklear”, zëvendësohet me shtojcën nr. 5, “Paketa e implantit koklear”;

dh) Shtojca nr. 7, “Paketa e shërbimeve të radioterapisë (me akselerator linear)”, zëvendësohet me shtojcën nr. 7, “Paketa e shërbimeve të radioterapisë (me akselerator linear)”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Fondi financohet paketat e shërbimeve shëndetësore, bazuar në koston e shërbimeve sipas shtojcave përkatëse, në institucionet shëndetësore publike. Financimi i institucioneve shëndetësore jopublike bazohet në çmimin e përcaktuar në shtojcat e këtij vendimi. Personat e siguruar që përfitojnë nga këto paketa janë të përjashtuar nga bashkëpagesa.”.

3. Pika 9, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA E PAKETAVE TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE QË DO TË FINANCOHEN NGA
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Shtojca nr. 1

Paketa e shërbimit të dializës		Kostoja (në lekë)	Marzhi i fitimit (në %)	Çmimi (në lekë)
1	Seanca e dializës <i>Në këtë seancë përfshihen:</i> - ekzaminimet e nevojshme biokimike klinike dhe mikrobiologjike; - kryerja e procedurës.	11,530	5	12,106
2	Kryerja e interventit për vendosjen e fistulës së thjeshtë.	10,705	8	11,561
3	Kryerja e interventit për vendosjen e graftit të thjeshtë <i>Në këtë procedurë përfshihen:</i> interventi dhe grafti me përbërje të thjeshtë.	50,288	8	54,311



Shtojca nr. 2

Paketa e shërbimeve të kardiologjisë		Kostoja (në lekë)	Marzhi i fitimit (në %)	Çmimi (në lek)
1	Angiografi koronare <i>Në këtë paketë përfshihen:</i> procedura dhe një ditë qëndrimi në pavijon (duke përfshirë edhe ekzaminimet).	42,333	8	45,720
2	Angioplastikë koronare (PTCA + 1.8 stent) <i>Në këtë paketë përfshihen:</i> procedura, një ditë qëndrimi në terapinë intensive dhe një ditë qëndrimi në pavijon (duke përfshirë edhe ekzaminimet).	129,652	8	140,024
3	Angiografi koronare + angioplastikë koronare (PTCA+ stent) <i>Në këtë paketë përfshihen:</i> procedura, një ditë qëndrimi në terapinë intensive dhe një ditë qëndrimi në pavijon (duke përfshirë edhe ekzaminimet).	138,148	8	149,200
4	Pacemaker definitiv <i>Në këtë paketë përfshihen:</i> procedura, një ditë qëndrimi në terapinë intensive dhe një ditë qëndrimi në pavijon (duke përfshirë edhe ekzaminimet). Procedura e vendosjes së aparatit. Vlera e aparatit të <i>pacemaker</i> -it.	100,225	8	108,243
4/1		46,255		
4/2		53,970		

Shtojca nr. 3

Paketa e shërbimeve të kardiokirurgjisë		Kostoja (në lekë)	Marzhi i fitimit (në %)	Çmimi (në lek)
1	Bypass aorto koronar	413,586	8	446,673
1/1	<i>Bypass + plastikë e valvulës.</i>	462,862	8	499,891
1/2	<i>Bypass + zëvendësim me valvul mekanike.</i>	484,475	8	523,233
1/3	<i>Bypass + zëvendësim me valvul biologjike.</i>	501,989	8	542,148
1/4	<i>Bypass + zëvendësim me valvul mekanike: 1 valvul aortale + 1 valvul mitrale.</i> <i>Në këto paketa përfshihen:</i> një ditë qëndrimi preoperator, ndërhyrja, dy ditë qëndrimi në terapinë intensive dhe pesë ditë qëndrimi në pavijon (duke përfshirë edhe ekzaminimet).	590,528	8	637,771
2	Valvular			
2/1	<i>Monovalvular me protezë mekanike.</i>	487,230	8	526,208
2/2	<i>Monovalvular me protezë biologjike.</i>	510,789	8	551,652
2/3	<i>BI valvular me protezë mekanike.</i>	606,603	8	655,132
2/4	<i>BI valvular me protezë biologjike.</i> <i>Në këto paketa përfshihen:</i> një ditë qëndrimi preoperator, ndërhyrja, dy ditë qëndrimi në terapinë intensive, si dhe pesë ditë qëndrimi në pavijon (duke përfshirë edhe ekzaminimet).	623,272	8	673,133
3	Congenital <i>Në këtë paketë përfshihen:</i> një ditë qëndrimi preoperator, ndërhyrja, dy ditë qëndrimi në terapinë intensive në shërbimin e kardiokirurgjisë, dy ditë qëndrimi në terapinë intensive në shërbimin e pediatrikë dhe pesë ditë qëndrimi në pavijon (duke përfshirë edhe ekzaminimet).	323,632	8	349,523



Shtojca nr. 4

Paketa e shërbimit të transplantit të veshkës dhe flakjes akute		Kostoja (në lekë)	Marzhi i fitimit (në %)	Çmimi (në lekë)
1	Paketa e shërbimit të transplantit të veshkës dhe flakjes akute <i>Në këtë paketë përfshihen:</i> Ekzaminimet para transplantit për marrësin e dhuruesin; Klinike biokimike; Imunologjike; Markuesit tumoralë; Imazheri virologjike; Konsultat; Operacioni dhe ndjekja; Ekzaminimet pas transplantit për marrësin e dhuruesin; Terapia e induksionit; Imunosupresorët (dozimi në gjak.	1,066,613	8	1,151,942
1/1	Terapia e flakjes akute	439,000	8	474,120

Shtojca nr. 5

Paketa e implantit koklear		Kostoja (në lekë)	Marzhi i fitimit (në %)	Çmimi (në lekë)
	Interventi kirurgjikal Aparati	168,849 2,580,900	8	182,357 2,580,900
	<i>Në këtë paketë përfshihen:</i> Ndërhyrja dhe aparatura e implantit koklear, sipas standardeve të Bashkimit Evropian.			
	Totali	2,749,749		2,763,257

Shtojca nr. 7

Paketa e shërbimeve të radioterapisë (me akseleratorin linear)		Kostoja (në lekë)	Marzhi i fitimit (në %)	Çmimi (në lekë)
1	Paketa e trajtimit paliativ (1–10 seanca trajtimi) <i>Në këtë paketë përfshihen:</i> Ekzaminimet dhe konsultat e nevojshme dhe seancat me akselerator linear.	5584	5	5,863
2	Paketa e trajtimit adjuvant/neoadjuvant (15–33 seanca trajtimi) <i>Në këtë paketë përfshihen:</i> Ekzaminimet dhe konsultat e nevojshme, si dhe trajtimi me akselerator linear.	4052	5	4,255
3	Paketa e trajtimit radikal (15–35 seanca trajtimi) <i>Në këtë paketë përfshihen:</i> Ekzaminimet dhe konsultat e nevojshme, si dhe trajtimi me akselerator linear.	4339	5	4,556
4	Paketa e trajtimit me IMRT (15–39 seanca trajtimi) <i>Në këtë paketë përfshihen:</i> Konsultat e nevojshme dhe trajtimi me akselerator linear (IMRT).	4635	5	4,867



VENDIM
Nr. 103, datë 5.2.2020

**PËR CAKTIMIN E AGJENCISË
KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT (AKSHI), SI NJËSI
ZBATUESE PËR NGRITJEN E
PORTALIT UNIK QEVERITAR TË
PROCESIT TË RINDËRTIMIT DHE
FINANCIMIN E TIJ NGA FONDI I
RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjes “iii”, të shkronjës “b”, të nenit 13, të pikës 3, të nenit 16, dhe të pikës 1, të nenit 38, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) si njësi zbatuese për ngritjen e portalit unik qeveritar të procesit të rindërtimit.

2. Efekti financiar total prej 19 440 360 (nëntëmbëdhjetë milionë e katërqind e dyzet mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekësh të përballohet nga zëri “Fondi për rindërtim”, miratuar në buxhetin e vitit 2020 dhe të përdoret nga AKSHI, përkatësisht:

a) në masën 18 360 360 (tetëmbëdhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”; dhe

b) në masën 1 080 000 (një milion e tetëdhjetë mijë) lekë, në zërin “Shpenzime operative dhe mirëmbajtje”.

3. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave, në zbatim të këtij vendimi, kthehen në buxhetin e shtetit në zërin “Fondi për rindërtim”.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

UDHËZIM
Nr. 4, datë 29.1.2020

**PËR DELEGIMIN E TË DREJTAVE DHE
TË DETYRAVE NË NJËSITË E
QEVERISJES SË PËRGJITHSHME**

Tiranë, 2020

PËRMBAJTJA

I. TË PËRGJITHSHME

**II. KUPTIMI DHE RREGULLA TË
DELEGIMIT**

**III. PROCEDURA E DELEGIMIT SIPAS
AUTORITETIT QË DELEGON**

3.1 Titullari

3.2 Nëpunësi i Parë Autorizues

3.3 Nëpunësi Autorizues

3.4 Nëpunësi Zbatues

3.5 Menaxherët e tjerë

**3.6 Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të
Programit Buxhetor**

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

V. ANEKSE

LISTA E SHKURTIMEVE

MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NPA	Nëpunësi i Parë Autorizues
NA	Nëpunësi Autorizues
Koordinator i MFK-së	Koordinatori i Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit
KR	Koordinatori i Riskut
MR	Menaxhim Risku
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
EMP	Ekipi i Menaxhimit të Programit



UDHËZIM PËR DELEGIMIN E TË DREJTAVE DHE TË DETYRAVE NË NJËSITË E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në mbështetje të nenit 6, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë udhëzon si më poshtë vijon:

I. TË PËRGJITHSHME

1.1 Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave, i procedurave që duhet të ndiqen në procesin e delegimit të të drejtave dhe detyrave, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

1.2 Ky udhëzim shërben si udhëzim standard ndërsa formularët pjesë përbërëse e këtij akti, (anekset 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9) shërbejnë si shembuj referues dhe ndihmës.

II. KUPTIMI DHE RREGULLA TË DELEGIMIT

2.1 Delegimi është procedura sipas së cilës një punonjës i njësisë së qeverisjes së përgjithshme i jep një punonjësi tjetër, autoritet për të vepruar në emër të tij, duke mos e ngatërruar këtë përkufizim me urdhrat apo udhëzimet që u jepen vartësve.

2.2 Delegimi i të drejtave dhe i detyrave realizohet në zbatim të hierarkisë dhe të strukturës organizative. Delegimi bëhet te punonjësit në varësi direkte pas punonjësit që delegon dhe, nëse ka mungesa në këto pozicione, mund të kalohet në nivelet e mëposhtme të varësisë.

2.3 Delegimi i të drejtave dhe i detyrave është një instrument që ndihmon në realizimin e të gjitha kompetencave të përcaktuara ligjore.

2.4 Delegimi i të drejtave dhe i detyrave i shërben rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së njësisë publike, duke përdorur me eficiencë burimet dhe kohën e menaxherëve për realizimin e objektivave.

2.5 Në këtë udhëzim përcaktohen rastet e delegimit, që kryhen jo në mungesë të autoritetit që delegon.

2.6 Nuk mund të delegohen të drejtat dhe detyrat, për të cilat ndalohet shprehimisht delegimi në ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin apo në ligje të tjera.

2.7 Delegimi i të drejtave dhe i detyrave nuk cenon të drejtat e menaxherit dhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e objektivave, kontrollin e risqeve përkatëse apo për përzgjedhjen e vartësit, tek i cili delegohen të drejtat dhe detyrat.

2.8 Menaxherët e niveleve të ndryshme duhet të përcaktojnë kriteret për të gjykuar se çfarë mund të delegojnë, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj. Kriteret që mund të vijnë në ndihmë janë:

- a) përcaktimi i personave të duhur që do të realizojnë detyrën;
- b) burimet në dispozicion;
- c) disponueshmëria e punonjësit/e vartësit për të bërë një detyrë të caktuar;
- ç) shpejtësia e përgjigjes së kërkuar;
- d) konfidencialiteti;
- dh) kompleksiteti i realizimit të detyrës;
- e) pasojat;
- ë) vlerat dhe imazhi.

2.9 Urdhri i delegimit mund të kundërshtohet me shkrim nga ana e punonjësit të cilit i delegohen të drejta dhe detyra, nëse është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Akti i kundërshtuar i paraqitet punonjësit që ka bërë delegimin përkatës. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet punonjësit që delegon dhe atij të cilit i delegohen të drejta dhe detyra, të dyja palët paraqesin urdhrin e kundërshtuar me shkrim, në një hallkë hierarkike më lart, në varësi direkte të të cilit është punonjësi që delegon.

III. PROCEDURA E DELEGIMIT SIPAS AUTORITETIT QË DELEGON

3.1 Titullari

Përgjegjësité e titullarit janë përcaktuara në nenin 8, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar. Titullarët e njësisë publike, në kuptim të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësisë publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit



financiar dhe të kontrollit, si dhe të përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë.

Titullarët e njësive publike, në fushën e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, kanë këto detyra kryesore:

a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të planveprimeve për arritjen e objektivave;

b) ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik të njësive publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27, pika 2, të ligji të menaxhimit financiar dhe të kontrollit;

c) miratimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit;

ç) miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen enxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësive publike, sipas udhëzimeve tënxjerra nga ministri përgjegjës për financave;

d) propozimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësi të tyre, përveç rasteve kur legjislacioni i posaçëm parashikon ndryshe;

dh) rregullimin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe garantimin e pavarësisë funksionale të tij;

e) futjen e procedurave antikorrupsion, bazuar në legjislacionin në fuqi;

ë) sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.

Titullari i njësive publike mund të delegojë disa nga të drejtat dhe detyrat e mësipërme, duke marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara në pikën 2.8 të këtij udhëzimi, si dhe duke specifikuar kërkesën për raportim periodik për realizimin e detyrave të deleguara, sipas formatit në aneksin 1.

3.2 Nëpunësi i Parë Autorizues

Përgjegjësitë e Nëpunësit të Parë Autorizues (NPA), janë përcaktuara në nenin 7, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar. Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse për financat është NPA për njësitë e qeverisjes qendrore, fondet speciale dhe fondet e transferuara te

njësitë e qeverisjes vendore. NPA përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për financat për menaxhimin e sistemit buxhetor, si dhe për monitorimin e zbatimit të kontrollit të brendshëm financiar publik dhe i paraqet komisionit përkatës parlamentar raporte për ecurinë, si dhe pasqyrat financiare e raportin vjetor për zbatimin e buxhetit në Republikën e Shqipërisë. Me kërkesë të komisionit raporton gjatë vitit edhe për çështje të tjera, që kanë lidhje me zbatimin e buxhetit dhe kontrollin e brendshëm financiar publik.

NPA, në fushën e menaxhimit financiar dhe të kontrollit ka përgjegjësi të mirëpërcaktuara nëpërmjet akteve të ndryshme ligjore dhe nënligjore për ushtrimin e funksioneve të mëposhtme:

a) planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit;

b) harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik;

c) inspektimin financiar publik.

NPA mund të delegojë disa të drejta apo detyra të përcaktuara në udhëzimet specifike për tri fushat e përcaktuara si më sipër, duke specifikuar kërkesën për raportim periodik për realizimin e detyrave të deleguara sipas formatit në aneksin 2.

3.3 Nëpunësi Autorizues

Përgjegjësitë e Nëpunësit Autorizues (NA), janë përcaktuara në nenin 9, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

NA të të gjitha niveleve të njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe të kontrollit kanë të drejtë delegimi të detyrave të mëposhtme:

a) koordinimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit dhe koordinimin e riskut;

b) hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuar nga titullari i njësive publike;

c) monitorimin e kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësive që menaxhojnë;

ç) planifikimin, menaxhimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar të veprimtarisë së njësive publike;



d) krijimin e kushteve për menaxhim të ligjshëm, efektiv e të përshtatshëm dhe për sjellje etike të punonjësve të njësisë;

dh) përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe për mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë, kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar.

NA, në cilësinë e Koordinatorit të Riskut (KR), ka të drejtë delegimi të detyrave të më poshtme:

a) bashkërendimin e aktiviteteve në lidhje me menaxhimin e risqeve (krijimin e regjistrit të riskut të institucionit);

b) këshillimin në lidhje me efektivitetin dhe efikasitetin e sistemit të MR-së;

c) informimin dhe komunikimin efektiv për risqet, brenda njësisë publike dhe me njësitë e tjera publike me ndikim në veprimtarinë e tyre;

ç) hartimin dhe ndjekjen e strategjisë së risqeve.

NA mund të delegojë të drejta apo detyra e sipërpërmendura, duke marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara në pikën 2.8 të këtij udhëzimi, si dhe duke specifikuar kërkesën për raportim për realizimin e detyrave të deleguara sipas formatit në aneksin 3.

NA të të gjitha niveleve të njësisë publike nuk kanë të drejtë delegimi të detyrave të mëposhtme:

a) propozimet për titullarin e njësisë publike për sistemin e rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi;

b) mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të njësisë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

c) ndarjen e përgjegjësive që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë e deleguara.

NA, në cilësinë e Koordinatorit të Riskut (KR) nuk ka të drejtë delegimi të detyrave të më poshtë:

a) raportimin sipas shkallës hierarkike për sistemin e kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtimit dhe të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave ose risqe, të cilat nuk janë adresuar

nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejton;

b) ngritjen dhe funksionimin e sistemit të MR-së, përcaktimin e nivelit të oreksit të riskut;

c) vlerësimin e sistemit të MR-së;

ç) paraqitjen e raportit të përgjithshëm të GMS-ja dhe titullari, duke identifikuar edhe risqet kryesore;

d) inkurajimin e kulturës së menaxhimit të riskut në të gjitha nivelet.

NA, në cilësinë e koordinatorit të MFK-së dhe KR-së mund të delegojë disa prej detyrave të tij, të një punonjësi i zyrës së financës, në bazë të nenit 10, të ligjit të MFK-së. Më specifikisht, detajimet gjenden në udhëzimin nr. 16, datë 20.7.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Delegimi mund të bëhet duke marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara në pikën 2.8 të këtij udhëzimi, si dhe duke specifikuar kërkesën për raportim për realizimin e detyrave të deleguara, sipas formatit në aneksin 5 dhe 6.

3.4 Nëpunësi zbatues

Përgjegjësitë e nëpunësit zbatues (NZ) janë përcaktuara dhe listuar në nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara Nëpunësit Autorizues përkatës, për detyrat si më poshtë vijojnë, të cilat mund të delegohen:

a) përgatitjen e dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë ku punojnë;

b) llogaritjen e kostove të veprimtarive të përcaktuara nga drejtuesit e programeve;

c) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë;

ç) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi;



d) mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, të raportimit për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, në përputhje me rregullat e miratuara nga ministria e përgjegjëse për financat. Sistemi i kompjuterizuar i thesarit mund të përdoret për kontabilizimin dhe raportimin e transaksioneve financiare të njësisë publike, bazuar në kriteret e vendosura nga ministria e përgjegjëse për financat;

dh) ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar;

NZ ka të drejtën të delegojë disa nga të drejtat dhe detyrat te vartësit funksionale, duke marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara në pikën 2.8 të këtij udhëzimi, si dhe duke specifikuar kërkesat për raportimin për realizimin e detyrave të deleguara sipas formatit në aneksin 4.

NZ të të gjitha niveleve të njësisë publike nuk kanë të drejtë delegimi të detyrave, si më poshtë vijojnë:

a) garantimin para miratimit të shkresave/të urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, të eficiencës dhe të efektivitetit;

b) mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve në varësi funksionale të tij, si dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional;

c) pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

ç) garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mblidhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta;

d) garantimin që të gjithë kreditorët të paguhën në kohë dhe, në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mospagesë nga kreditorët, nëpunësi zbatues duhet t'ia shpjegojë rrethanat. Nëpunësit Autorizues;

dh) garantimin e cilësisë së dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë publike, në rolin e sekretarit të Grupit të Menaxhimit Strategjik të njësisë publike;

e) garantimin e cilësisë së raportimit periodik për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, si dhe të pasqyrave financiare vjetore të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga ministri përgjegjës për financat.

3.5 Menaxherët e tjerë

Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë janë përcaktuar në nenin 11 të ligjit të MFK-së, të ndryshuar. Në përmbushje të përgjegjësisë të tyre, menaxherët e niveleve të ndryshme, mund t'i delegojnë disa prej detyrave, punonjësve të tjerë në varësi të tyre, duke përcaktuar qartë edhe linjën e raportimit dhe afatet për raportim.

Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike kanë detyra të cilat mund të delegohen dhe të raportojnë duke i dhënë llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për:

a) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë;

b) ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar.

Në fushën e menaxhimit të riskut:

a) identifikimin, vlerësimin dhe vendosjen e përparësive në lidhje me risqet;

b) identifikimin, vlerësimin, përcaktimin e aktiviteteve të kontrollit dhe menaxhimin e risqeve;

c) përgatitjen dhe përditësimin e regjistrit të riskut jo më pak se dy herë në vit;

ç) përcaktimin dhe monitorimin e riskut të pranuar.

Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike kanë detyra të cilat nuk mund të delegohen dhe raportojnë duke i dhënë llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për:



a) mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të strukturës që drejtojnë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional;

b) garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në strukturat që ata drejtojnë, bazuar në rregullat e vendosura nga titullari i njësisë publike, si dhe i raportojnë Nëpunësit Autorizues përkatës për çdo dobësi të sistemit që duhet trajtuar;

c) informacionin në kohë dhe në formën e kërkuar për rezultatet e arritura gjatë përmbushjes së përgjegjësisë të tyre, për risqet dhe defektet serioze në veprimtarinë e strukturave që drejtojnë, si dhe për masat e marra e të zbatuara për riparimin e këtyre defekteve.

Në fushën e menaxhimit të riskut:

a) monitorimin e vazhdueshëm të risqeve;

b) të sigurojnë se të gjithë punonjësit janë të njohur me procesin e MR-së dhe me kërkesat e vendosura për këtë qëllim;

c) inkurajimin e kulturës së MR-së në të gjitha nivelet;

ç) krijimin e kushteve të favorshme për zbatimin me lehtësi të të gjitha aktiviteteve që lidhen me risqet e përcaktuara dhe specifikuara në planin e veprimit (nëse është e nevojshme të zhvillojnë një plan veprimi të detajuar);

d) të sigurojnë se MR-ja është një temë e rregullt diskutimi në takimet me strukturat drejtuese të tyre;

dh) të sigurojë një raportim sistematik dhe në kohë për GMS-në, në lidhje me riskun në nivel njësie publike;

e) të sigurojë MR-në në bazë ditore;

ë) të sigurojë se MR-ja, në fushën e tij/e saj të përgjegjësisë kryhet sipas strategjisë së MR-së;

f) të caktojë një person përgjegjës për dhënien e asistencës teknike në menaxhimin e risqeve nën përgjegjësinë e tij/e saj.

Të gjitha nivelet e menaxherëve mund të delegojnë disa prej të drejtave dhe detyra të sipërpërmendura, duke marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara në pikën 2.8 të këtij udhëzimi, si dhe duke specifikuar kërkesën për raportim periodik për realizimin e detyrave të deleguara sipas formatit në aneksin 7.

3.6 Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programit Buxhetor

Përkufizimi dhe përgjegjësitë e drejtuesve të Ekipit të Menaxhimit të Programit Buxhetor

(drejtuesit e EMP-së) janë të përcaktuar në udhëzimin nr. 7, datë 28.2.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

Drejtuesit e EMP-së kanë të drejtën e delegimit të detyrave të mëposhtme:

a) propozimin e anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit të Programit të tyre, për t’u miratuar nga Grupi për Menaxhimin Strategjik dhe titullari si kryetar i këtij grupi;

b) shpërndarjen të të gjithë anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programit të dokumenteve dhe të materialeve të nevojshme për procesin e programit buxhetor afatmesëm;

c) menaxhimin e procesit të zbatimit të procedurave të përgatitjes së kërkesave buxhetore në lidhje me programin përkatës;

ç) hartimin e një kalendarit aktiviteteve për anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programit për të garantuar respektimin e afateve të përcaktuara në kalendarin e njësisë së qeverisjes qendrore dhe të fondeve speciale;

d) organizimin e takimeve të Ekipit të Menaxhimit të Programit në etapa të ndryshme të procesit të përgatitjes së kërkesave buxhetore dhe përfshirjen e këtyre takimeve në kalendarin e përmendur më lart;

dh) drejtimin e anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit të Programit drejt konsensusit apo marrëveshjes në secilën etapë të procesit të përgatitjes së kërkesave buxhetore;

e) përcaktimin për programin buxhetor në përgjegjësinë e tyre, minimalisht të një objektivi të politikës që adreson respektimin e plotë të barazisë gjinore ose promovon barazinë gjinore në fushën/sectorin përkatës. Këta objektiva duhet të jenë të shoqëruar me tregues të përshtatshëm dhe të matshëm performance, ku do të synohet që të identifikohet një ose disa produkte me kostot përkatëse që do të kontribuojnë në realizimin e tyre;

ë) rishikimin e raporteve në përputhje me procedurat e prezantuara në këtë udhëzim, si dhe udhëzimet vjetore të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, në rastet kur këto raporte të prezantuara te Grupi për Menaxhimin Strategjik nuk janë miratuar dhe/ose nuk janë nënshkruar nga kryetari i këtij grupi;

f) koordinimin e punës së Ekipit të Menaxhimit të Programit me nëpunësin zbatues.



Drejtuesit e EMP-së mund të delegojnë disa nga detyrat e sipërcituara, duke marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara në pikën 2.8 të këtij udhëzimi, si dhe duke specifikuar kërkesën për raportim periodik për realizimin e detyrave të deleguara sipas formatit në aneksin 8.

Drejtuesit e EMP-së kanë këto detyra të cilat nuk mund të delegohen:

a) drejtuesit e EMP-së janë përgjegjës dhe raportojnë, përpara Nëpunësit Autorizues, për hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave, treguesve të performancës dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit;

b) drejtuesit e programit janë përgjegjës për të garantuar që janë duke u realizuar siç duhet përgjegjësitë e Ekipit të Menaxhimit të Programit, si një komponent kyç i organizimit institucional për përgatitjen e kërkesave buxhetore;

c) drejtuesit e programit kanë përgjegjësinë për të marrë pjesë në takimet e Grupit për Menaxhimin Strategjik, duke marrë pjesë në çdo diskutim, si dhe vendimmarrjet përkatëse që kanë ndikim mbi programin e tyre;

ç) ushtrimin e autoritetit për plotësimin e formateve të kërkesave buxhetore, atëherë kur marrëveshja apo konsensusi nuk mund të arrihet;

d) nënshkrimin e raporteve të përgatitura nga Ekipi i Menaxhimit të Programit për t'u dorëzuar te Grupi për Menaxhimin Strategjik;

dh) raportimin te koordinatori i Grupit për Menaxhimin Strategjik i të gjitha mosmarrëveshjeve të lindura brenda Ekipit të Menaxhimit të Programit, në lidhje me përgatitjen e kërkesave buxhetore.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

4.1 Bashkëlidhur këtij udhëzimi gjeni një matricë delegimi për ministritë e linjës, në rubrikën “Aneksë”, për t'u marrë në konsideratë si një shembull referues dhe ndihmës (aneksi 9).

4.2 Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

4.3 Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare

MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Anila Denaj



V. ANEKSE

ANEKSI 1

Logo institucioni

Nr. _____ prot. Tiranë, më ____ . ____ . _____

AUTORIZIM DELEGIMI TË DETYRAVE TË TITULLARIT

Bazuar në nenet 8, 15 dhe 22, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, në udhëzimin nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe në udhëzimin nr. 7, datë 28.2.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, autorizoj z./znj. _____, me detyrë _____, si titullar të deleguar, duke nisur nga data _____ deri në datën _____.

1. Nëpunësi në cilësinë e titullarit të deleguar autorizohet për kryerjen e detyrave si më poshtë:

☐
☐
☐
☐

2. Raportimi kryhet te titullari çdo _____ (periudha kohore: çdo ditë/javë)

për realizimin e detyrave të deleguara.

3. Raportimi kryhet sipas formatit bashkëlidhur (formati përcaktohet nga titullari).

4. Delegimi i të drejtave dhe detyrave nuk cenon të drejtat e titullarit dhe nuk shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e detyrave përkatëse.

TITULLARI



ANEKSI 2

Logo institucioni

Nr. _____ prot. Tiranë, më ____ . ____ . _____

**AUTORIZIM DELEGIMI TË DETYRAVE
TË NËPUNËSIT TË PARË AUTORIZUES**

Bazuar në nenet 7, 15 dhe 22, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, në udhëzimin nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat Standarde të zbatimit të buxhetit” dhe në udhëzimin nr. 7, datë 28.2.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, autorizoj z./znj. _____, me detyrë _____, si Nëpunës të Parë Autorizues të deleguar, duke nisur nga data _____ deri në datën _____.

1. Nëpunësi në cilësinë e NPA të deleguar autorizohet për kryerjen e detyrave si më poshtë:

☐
☐
☐
☐

2. Raportimi kryhet te Nëpunësi i Parë Autorizues çdo _____ (periudha kohore: çdo ditë/javë) për realizimin e detyrave të deleguara.

3. Raportimi kryhet sipas formatit bashkëlidhur (formati përcaktohet nga Nëpunësi i Parë Autorizues).

4. Delegimi i të drejtave dhe detyrave nuk cenon të drejtat e Nëpunësit të Parë Autorizues dhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e detyrave përkatëse.

NËPUNËSI I PARË AUTORIZUES



ANEKSI 3

Logo institucioni

Nr. _____ prot. Tiranë, më ____ . ____ . _____

AUTORIZIM DELEGIMI TË DETYRAVE TË NËPUNËSIT AUTORIZUES

Bazuar në nenet 9, 15 dhe 22, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, në udhëzimin nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe në udhëzimin nr. 7, datë 28.2.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, autorizoj z./znj. _____, me detyrë _____, si Nëpunës Autorizues të deleguar, duke nisur nga data _____ deri në datën _____.

1. Nëpunësi në cilësinë e NA të deleguar autorizohet për kryerjen e detyrave si më poshtë:

- ☐
- ☐
- ☐
- ☐

2. Raportimi kryhet te Nëpunësi Autorizues çdo _____ (periudha kohore: çdo ditë/javë) për realizimin e detyrave të deleguara.

3. Raportimi kryhet sipas formatit bashkëlidhur (formati përcaktohet nga Nëpunësi Autorizues).

4. Delegimi i të drejtave dhe detyrave nuk cenon të drejtat e Nëpunësit Autorizues dhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e detyrave përkatëse.

NËPUNËSI AUTORIZUES



ANEKSI 4

Logo institucioni

Nr. _____ prot. Tiranë, më ____ . ____ . _____

AUTORIZIM DELEGIMI TË DETYRAVE TË NËPUNËSIT ZBATUES

Bazuar në nenet 12, 15 dhe 22, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, në udhëzimin nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe në udhëzimin nr. 7, datë 28.2.2018, “Për Procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, në udhëzimit nr. 21, datë 25.10.2016, “Për përgjegjësitë e nëpunësit zbatues”, autorizoj z./znj. _____, me detyrë _____, si Nëpunës Zbatues të deleguar, duke nisur nga data _____ deri në datën _____.

1. Nëpunësi në cilësinë e NZ-së të deleguar autorizohet për kryerjen e detyrave si më poshtë:

- ☐
- ☐
- ☐
- ☐
- ☐
- ☐

2. Raportimi kryhet te Nëpunësi Zbatues çdo _____ (periudha kohore: çdo ditë/javë) për realizimin e detyrave të deleguara.

3. Raportimi kryhet sipas formatit bashkëlidhur (formati përcaktohet nga Nëpunësi Zbatues).

4. Delegimi i të drejtave dhe detyrave nuk cenon të drejtat e Nëpunësit Zbatues dhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e detyrave përkatëse.

NËPUNËSI ZBATUES



ANEKSI 5

Logo institucioni

Nr. _____ prot. Tiranë, më ____ . ____ . _____

AUTORIZIM DELEGIMI TË DETYRAVE TË KOORDINATORIT TË RISKUT

Bazuar në nenet 10, 15 dhe 22, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, në udhëzimin nr. 16, datë 20.7.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut”, autorizoj z./znj. _____, me detyrë _____ (punonjës i financës) si KR i deleguar, duke nisur nga data _____ deri në datën _____.

1. Nëpunësi në cilësinë e KR të deleguar autorizohet për kryerjen e detyrave si më poshtë:

☐
☐
☐
☐
☐

2. Raportimi kryhet te Nëpunësi Autorizues çdo _____ (periudha kohore: ditë/javë) për realizimin e detyrave të deleguara.

3. Raportimi kryhet sipas formatit bashkëlidhur (formati përcaktohet nga Nëpunësi Autorizues).

4. Delegimi i të drejtave dhe i detyrave nuk cenon të drejtat e Nëpunësit Autorizues dhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e detyrave përkatëse.

NËPUNËSI AUTORIZUES



ANEKSI 6

Logo institucioni

Nr. _____ prot. Tiranë, më ____ . ____ . _____

**AUTORIZIM DELEGIMI TË DETYRAVE TË KOORDINATORIT TË MENAXHIMIT
FINANCIAR DHE KONTROLLIT**

Bazuar në nenet 10, 15 dhe 22, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, në udhëzimin nr. 16, datë 20.7.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut”, autorizoj z./znj. _____, me detyrë _____ (punonjës i financës) si të koordinator i deleguar i MFK, duke nisur nga data _____ deri në datën _____.

1. Nëpunësi në cilësinë e koordinatorit të deleguar të MFK autorizohet për kryerjen e detyrave si më poshtë:

- ☐
- ☐
- ☐
- ☐
- ☐
- ☐

2. Raportimi kryhet te nëpunësi autorizues çdo _____ (periudha kohore: ditë/javë) për realizimin e detyrave të deleguara.

3. Raportimi kryhet sipas formatit bashkëlidhur (formati përcaktohet nga Nëpunësi Autorizues).

4. Delegimi i të drejtave dhe detyrave nuk cenon të drejtat e Nëpunësit Autorizues dhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e detyrave përkatëse.

NËPUNËSI AUTORIZUES



ANEKSI 7

Logo institucioni

Nr. _____ prot. Tiranë, më ____ . ____ . _____

**AUTORIZIM DELEGIMI TË DETYRAVE TË MENAXHERËVE TË NIVELE TË
NDRYSHME**

Bazuar në nenet 11, 15 dhe 22, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, udhëzimeve në zbatim të tij dhe në përputhje me detyrat funksionale, autorizoj z./znj. _____, me detyrë _____, si _____ (menaxher) i deleguar duke nisur nga data _____ deri në datën _____.

1. Nëpunësi në cilësinë e menaxherit të deleguar autorizohet për kryerjen e detyrave si më poshtë:

- ☐
- ☐
- ☐
- ☐
- ☐
- ☐

2. Raportimi kryhet te menaxheri urdhërues/nëpunësi urdhërues do të kryhet çdo _____ (periudha kohore: ditë/javë) për realizimin e detyrave të deleguara.

3. Raportimi kryhet sipas formatit bashkëlidhur (formati përcaktohet nga menaxheri urdhërues/nëpunësi urdhërues).

4. Delegimi i të drejtave dhe detyrave nuk cenon të drejtat e menaxherëve të niveleve të ndryshme që delegojnë dhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e detyrave përkatëse.

NËPUNËSI URDHËRUES



ANEKSI 8

Logo institucioni

Nr. _____ prot. Tiranë, më ____ . ____ . _____

**AUTORIZIM DELEGIMI TË DETYRAVE TË DREJTUESVE TË EKIPEVE TË
MENAXHIMIT TË PROGRAMIT BUXHETORE**

Bazuar në nenet 11, 15 dhe 22, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, udhëzimeve në zbatim të tij, udhëzimit nr. 7, datë 28.2.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, dhe në përputhje me detyrat funksionale, autorizoj z./znj. _____, me detyrë _____, si drejtues i EMP i deleguar, duke nisur nga data _____ deri në datën _____.

1. Nëpunësi në cilësinë e drejtuesit të EMP të deleguar autorizohet për kryerjen e detyrave si më poshtë:

- ☐
- ☐
- ☐
- ☐
- ☐
- ☐

2. Raportimi kryhet te drejtuesi i EMP dhe do të kryhet çdo _____ (periudha kohore: ditë/javë) për realizimin e detyrave të deleguara.

3. Raportimi kryhet sipas formatit bashkëlidhur (formati përcaktohet nga drejtuesi i EMP).

4. Delegimi i të drejtave dhe detyrave nuk cenon të drejtat e Drejtuesve të EMP që delegojnë dhe nuk e shkarkon atë nga përgjegjësia administrative për realizimin e detyrave përkatëse.

DREJTUESI I EMP



ANEKSI 9
MATRICA E DELEGIMIT NË MINISTRITË E LINJËS

Aktet	Kompetencat vendimmarrëse të ndara për ... (përcaktimi i personit përgjegjës)	Baza ligjore ku përcaktohen kompetencat vendimmarrëse (dispozitat përkatëse ligjore)	Delegimi i kompetencave vendimmarrëse (delegohet/ nuk delegohet)	Baza ligjore që lejon delegimin (dispozitat përkatëse ligjore)
Nxjerrja e akteve administrative	- Ministri (titullari) - Nëpunësi Autorizuar (Sekretari i Përgjithshëm)	Neni 2 i Kodit të Procedurave Administrative, në të cilin përcaktohen veprimtaritë administrative, ku ndër format e kësaj veprimtarie janë edhe aktet administrative. Ligji nr. 90/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, në të cilin përcaktohet e drejta e delegimit. Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, nenet 8, 9, 15.	Delegohet te Nëpunësi Autorizues/Sekretari i Përgjithshëm, nëpërmjet përcaktimeve në rregulloren e brendshme apo udhëzimit për ndarjen e përgjegjësive brenda një ministrie nëse ka një të tillë.	Neni 15 i ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i cili përcakton të drejtën e delegimit.
Miratimi i kërkesave buxhetore të ministrisë	Ministri (titullari)	Neni 19 i ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe pika 2.3/4 e udhëzimit nr. 7, datë 28.2.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”. Titullari i njësisë së qeverisjes qendrore ka përgjegjësi të miratimit të kërkesave buxhetore për çdo program të njësisë që mbulon dhe t’i dorëzojë në ministrinë përgjegjëse për financat.	Delegohet. NA/Sekretari i Përgjithshëm, mbi bazën e rregullave të brendshme dhe procedurave të miratuara nga titullari i njësisë së qeverisjes qendrore, përgjegjësitë për hartimin e kërkesave buxhetore duhet të shpërndahen nga Nëpunësi Autorizues te drejtuesit e programeve/Nëpunësit Autorizues të nivelit të dytë, e më tej, nëpërmjet një sistemi delegimesh/ndarje funksionesh me rregulla të qarta dhe të dokumentuara.	Pika 2.4/2 e udhëzimit nr. 7, datë 28.2.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.
Miratimi i rregullave specifike dhe i procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike	Ministri (titullari)	Pika 5 e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.	Delegohet. Mbi bazën e rregullave dhe procedurave të miratuara nga titullari i njësisë publike, përgjegjësitë për menaxhimin e aktiveve duhet të shpërndahen nga Nëpunësi Autorizues në njësinë publike nëpërmjet një sistemi delegimesh dhe ndarje funksionesh me rregulla të qarta dhe të dokumentuara. Çdo individ duhet të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij mbi aktivet e njësisë.	Pika 6 e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
Përfaqësimi i ministrisë si një autoritet kontraktues në prokurimin publik dhe përgjegjësia për realizimin e procedurave ligjore	NA/Sekretari i Përgjithshëm	1.Kreu III, i ligjit nr. 47/2017, “Për prokurimin publik” 2.	Nuk delegohet	Me rregulla të brendshme dhe në varësi të ndarjes së përgjegjësive.
Miratimi i regjistrimit vjetor të parashikimeve për prokurimet	NA/Sekretari i Përgjithshëm	VKM nr. 1, datë 10.1.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, pika 3, germa “b”, përcakton se në bazë të kërkesave për punë, mallra ose shërbime, autoriteti kontraktor është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrimit vjetor të parashikimeve	Nuk delegohet.	3.Mund të delegohet vetëm organizimi i brendshëm për të realizuar dokumentin, në mbështetje të rregullave të brendshme.



		për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që parashikohet në udhëzimet e APP-së. Brenda datës 20 janar të çdo viti, titullari i autoritetit kontraktor dërgon, pas miratimit, një kopje të regjistrit të parashikimeve të prokurimit në institucionin qendror, që vë në dispozicion fondet buxhetore. Brenda 15 shkurtit të çdo viti, institucioni qendror u dërgon APP-së dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Thesarit, në Ministrinë e Financave, një përmbledhje të regjistrit të parashikimeve të tij apo edhe të autoriteteve kontraktore të varësisë (nëse ka të tilla). Drejtoria e Buxhetit dhe Thesarit dërgon një kopje në zyrat e thesarit në rrethe.		
Pagesat e autorizuar (faturat, pagat etj.)	Nëpunësi Autorizues (Sekretari i Përgjithshëm)	Neni 54 i ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe pika 40 e udhëzimit nr. 9, datë 20.7.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.	Delegohet (menaxherëve të niveleve më të ulëta)	Pika 44 e udhëzimit nr. 9, datë 20.7.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, në të cilën përcaktohet se Nëpunësit autorizues të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, si dhe nëpunësit autorizues të nivelit të dytë kanë të drejtë delegimi të disa të drejtave lidhur me miratimin e shpenzimeve dhe urdhërimin e pagesave si rregull të drejtuesi i programit buxhetor ose drejtuesit e aktiviteteve kryesore të njësisë në vartësi direkt e të tyre në organikën e njësisë.
Propozimi për fillimin e ecurisë disiplinore	Nëpunësi Autorizues	Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 9.	Nuk delegohet	4.
Miratimi i lejes vjetore (për stafin poshtë nivelit të sekretarit)	- Nëpunësi Autorizues (Sekretari i Përgjithshëm); - Menaxherët e niveleve të ndryshme.	Neni 40 i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, e drejta për leje vjetore. Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar mbi përcaktimin e përgjegjësisë të Nëpunësit Autorizues.	Delegohet te menaxherët e niveleve të ndryshme menaxhojnë staf	Neni 15 i ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
Miratimi i kërkesave për konferenca dhe takime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit (për stafin poshtë nivelit të sekretarit)	Ministri/Nëpunësi Autorizues	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. VKM-të për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit.	Delegohet te NA/Sekretari i Përgjithshëm	Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 9, mbi përgjegjësitë e NA për mirëmenaxhimin e fondeve publike.
Miratimi i efekteve financiare për përballimin e trajnimeve brenda dhe jashtë vendit,	Ministri/NA	VKM-të për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit.	Delegohet tek NA/Sekretari i Përgjithshëm	Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 9, mbi përgjegjësitë e NA-së për mirëmenaxhimin e fondeve publike.



përfshijtur trajnimet pranë ASPA-s.				
Miratimi i Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vlerësimin e vitit paraardhës.	Nëpunësi Autorizues (Sekretari i Përgjithshëm)	Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 18.	E përjashtuar, për miratimin por e lejuar (te menaxherët e niveleve të ndryshme) vetëm për koordinimin	Neni 10 i ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
Miratimi i urdhrit për krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm	Titullari (ministri)	Neni 12 i ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.	Nuk delegohet	
Miratimin me urdhër të kartës së auditit	Titullari (ministri)	Neni 12 i ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.	Nuk delegohet	
Miratimi i planit strategjik dhe vjetor të njësisë së auditimit të brendshëm	Titullari (ministri)	Neni 12 i ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.	Nuk delegohet	
Miratimin e planit të veprimit	Titullari (ministri)	Neni 12 i ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Miratimin dhe ndjekjen e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit nga njësi e auditimit të brendshëm ose në përfundim të procedurave të vlerësimit të cilësisë së auditimit nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e Auditimit të Brendshëm.	Nuk delegohet	

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 1234 (5489), datë 30.10.2019, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Gentian Muhamet Beqiri, i lindur në datën 2.3.1991, në Elbasan dhe banues në Shkodër dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të shoqatës “Projekti Shpresa”, me seli në Shkodër.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 308 lekë